

THE STRUCTURE OF FATOS KONGOLI'S NOVELS STRUKTURA E ROMANEVE TË FATOS KONGOLIT

Adelina XHAFERI¹

¹Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*adelina.xhaferi@unite.edu.mk

Abstract

This literary work, inspired by Kongol's narrative prose will focus on the structure of the novels. In them, from a literary point of view, we will see in detail the special points in terms of the external appearance of the characters, as well as the internal one. Other times, the novels of this writer of the contemporary Albanian period will also look from a compositional point of view, as it is said to be the basic part for a work of a contemporary nature. This paper, encouraging for a more detailed presentation, as will be seen in it, will also give the way in which the same creations appear: the repetition of literary motifs, the nature of circular narratives, the nature of parallel narratives, or together with these as well the time reversals in the moments when they are not expected, not only by the character, but also by the reader himself who presents the external side of this literature. Thanks to this work that Kongoli has created for years, the paper will also show how important is the structure with which a novel is presented to us, especially when the character makes a voice and shows a difference from the previous ones.

Key words: *Albanian prose, character, events, mentality, Kongol*

Përmbledhja

Ky punim letrar, i nxitur nga proza narrative e Kongolit, do të përqendrohet në strukturën e romaneve. Në to, nga një këndvështrim letrar, do të shihen në hollësi pikat e veçanta për nga paraqitja e jashtme e personazheve, si dhe ajo e brendshme. Herë të tjera, punimi, romanet e këtij shkrimtari të periudhës bashkëkohore shqipe, do t'i shoh edhe për nga ana kompozicionale, meqë thuhet se është pjesa themelore për një vepër me natyrë bashkëkohore. Ky punim, duke mëtuar për një paraqitje sa më të hollësishme, siç do të shihet në punim, do të jep edhe mënyrën se si në të njëjtat krijime shfaqen: përsëritjet e motiveve letrare, natyrat e rrëfimeve unazore, natyrat e rrëfimeve paralele, ose bashkë me këto, edhe vetë përmbysjet kohore në çastet kur nuk priten, jo vetëm nga personazhi, por, edhe nga vetë lexuesi, i cili e paraqet anën e jashtme të kësaj letërsie. Falë kësaj pune që ka krijuar Kongoli për vite të tëra, edhe punimi do të tregojë se sa e rëndësishme është struktura me të cilën na paraqitet një roman, sidomos kur personazhi bën zë dhe tregon dallim nga ata të mëparshmit.

Fjalët kyçe: *proza shqipe, personazhi, ngjarjet, mentaliteti, Kongoli.*

Kur flitet për njerëz të mëdhenj, përveç të veçantave dhe risive që ata sjellin në art, i çfarëdo lloji qoftë ky i fundit, ose, veçanërisht në artin e letërsisë, meqë edhe tema e punimit është në këtë fushë, është e nevojshme të theksohen edhe pikat e përbashkëta që ata kanë me të tjerët, meqë jetojnë në rrethe dhe hapësira të caktuara. Vetë këto hapësira, janë arsyt kryesore të cilat ata (ose personazhet e tyre të mëvonshëm letrarë) e gjejnë veten në pika të ndryshme dhe atë e ndërlihin me të ardhmen; i urrejnë negativet, sa herë që i pengojnë të ecin përpara dhe t'i pranojnë ndryshimet sa më lirshëm; mëtojnë të shprehin botën e ndjenjave të brendshme, edhe kur ajo nuk u pranohet ose u mohohet për vetë "elementin ndryshe" dhe të panjohur që vjen e shfaqet në një kohë me karakteristika bartëse nga e vjetra; ose, fare në fund, zhduken në mënyra nga më interesantet, për të mos u shfaqur më kurrë.

Meqë vetë togfjalëshi “kohë e madhe” çon të mendohet për atë kohë, në të cilën, njerëzit e artit të letërsisë, arritën të lënë gjurmë të thella, nuk mund të lihet anash pa u përmendur se ato gjurmë hasen në: mënyrën e rrëfimit të ngjarjeve të përzgjedhura brenda veprave të caktuara letrare; në paraqitjen e personazhit (kryesor ose dytësor) dhe karakterizimin e tij (të jashtëm ose të brendshëm); në tematikën e fuqishme që ngërthejnë brenda vetëve e për të njëjtat dallohen, me ç’rast edhe i mbizotërojnë çdo kohe; në kritikën dhe gjykimet vetjake të shkrimtarit, si për çështjet jetësore e politike, ashtu edhe për artin letrar që krijon tjetri; në tipizimet ose huazimet e elementeve të huaja, të futura artistikisht brenda letërsive të tyre (qofshin ato elemente mitike, popullore, historike, shoqërore a psikologjike), ose në vetë elementet autobiografike të ngërthyera po brenda atyre veprave, të cilat, njëkohësisht përpos jetës së shkrimtarit, ndihmojnë që të njihen edhe veprimet ose reagimet e caktuara të personazheve të tij.

Mënyrat se si mund të bëhet qasja ndaj veprave letrare, pavarësisht se cilës periudhë i takojnë ato dhe ç’karakteristika ngërthejnë brenda vetëve, janë të ndryshme dhe me shenja dalluese. Gjithë kjo për vetë faktin që ndërlidhen edhe me shumë faktorë të natyrës së jashtme. Kur këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në vetë paraqitjen e veprës, të kushtëzuar edhe nga elementet e së njëjtës, del në pah një natyrë e veçantë shkrimi e një shkrimtarit të caktuar, e cila bën që ai të dallohet në një mentalitet, te i cili lënë gjurmë të thella edhe kushtëzimet paraprake të kohës. Ato më vonë mund të jetë në interes për shumë studiues, sidomos, për ata që rendin drejt gjërave që fshihen prapa një fytyre të dytë e që jetojnë ndryshe nga rrethi si hapësirë veprimi.

Por, kur në raste të caktuara, qasja ndaj këtyre veprave nxjerr në pah një anë ndryshe të shkrimtarit, i cili për shkak të gjuhës figurative arrin të mbetet i fshehtë për një kohë të gjatë dhe të mos hidhet tej vetëm pse nuk përkon me të tanishmen, është më në interes për studiuesit që t’u qasen të njëjtave dhe të japin mendime nisur nga këndvështrimet individuale. Ngase, pikërisht kjo gjuhë e fshehtë mund të jetë një urë lidhëse mes tij (atëherë kur ai e mishëron veten me personazhin e një proze të gjatë narrative) dhe një kohe tjetër (e marrë si element letrar), të cilën ai e shijon vetëm brenda rreshtave të veprës, dhe atë, përderisa e lexon dhe e përjeton me ëndje, është i gatshëm ta pranojë edhe në një kohë të së nesërme reale.

Mendimet e tilla nuk (ri)lindin dhe nuk burojnë vetëm pse një shkrimtar dallohet nga tjetri, meqë prek tema të pathëna e të patrajtuara më parë brenda artit letrar (qofshin ato edhe temat tabu, të cilat në letërsinë shqipe dhe në natyrën e personazheve të saj shfaqen me vonesë, për dallim nga letërsia e huaj), por, vijnë si pasojë e asaj që edhe kur ato janë të rrezikshme dhe kundërshtare për vetë sistemet dhe udhëheqësit e tyre, arrijnë të mbahen të mbuluara me pëlthurë shpresëdhënëse dhe të dalin përballë të tjerëve kur edhe realisht ndihet nevoja për to.

Vetë larmia e tillë e temave arrin të prekë çdo studiues, i cili, studimit të vet i rreket me vullnet, jo vetëm për të vërtetuar se një shkrimtar/re i/e caktuar është ndryshe edhe atëherë kur më së paku besohet për të, dhe mentaliteti ose bindjet e bartura nga e djeshmja nuk e mendojnë një paraqitje të tillë, por, për ta bindur veten se në punën e tillë me një rendje të vazhdueshme, ka diçka që atë e lumturon edhe për të fshehtën ose të paparën që ai arrin ta nxjerrë në dritë.

Nëse nga gjithë këto tema, pavarësisht ndjenjave të shkrimtarit dhe mënyrës se si ai shkruan e se si del para lexuesit, paraqitet dhe përshkruhet në mënyrë të hollësishme një mentalitet i shturur demokratik, me njerëz bashkëkohorë që shpesh, humbasin edhe identitetet personale, të fituara me mund e të ndara nga ai kolektiv; nëse në pika të imëta përshkruhet një mashkull/burrë bashkëkohor shqiptar, i cili, nën udhëheqjen e epsheve të shumta e të shfrenuara erotike merr në qafë qenie të brishta e të mitura, tradhton gruan pas një martese të gjatë dhe joshet në vazhdimësi nga tri gra në lidhje të ngushtë gjaku; nëse përshkruhet një grua bashkëkohore shqiptare, e cila, për “vëmendje mashkullore” mëton ta harrojë shtratin bashkëshortor dhe çdo të kaluar ta çojë dëm, pavarësisht natyrës që ka ajo; nëse na paraqitet një

vajzë e brishtë dhe e mitur, e cila keqpërdoret seksualisht nga i ati, dhe pas kësaj, përpos jetës, ajo urren thellësisht edhe shtëpinë prindërore (motiv ky jo i largët e jo i panjohur edhe për letërsinë e huaj), nga to lexuesi i këtyre prozave takohet me personazhe bashkëkohorë. Të gjithë këta personazhe, me karakteristika të veçanta, që shtynë të përfytyrohet ndonjë i njohur që edhe në vazhdimësi të kohës bën pjesë te të tjerët; të përfytyrohet një që takohet në hapësirat, të cilat detyrojnë të jenë të të gjithëve ose të braktisen në të kaluarën, thjesht për të mos u bartur me vete e nëpër kujtime; ose, edhe më thellë, të njihen e të takohen edhe me pjesë të vetëve, të cilat më parë nuk kanë pasur guxim të thuhën, bëjnë të pranohen elementet ekzistuese bashkëkohore, si dhe të bashkëjetojnë (ose të vuhet me to) për aq kohë sa edhe janë kudo përreth njerëzve.

Nëse gjithë ajo që do të arrihet të thuhet për prozën narrative bashkëkohore dhe për personazhin e Fatos Kongolit nëpërmjet këtij punimi të shkurtër letrar, do të jep një pasqyrim më të plotë mbi atë se si shihet krijimi dhe procesi krijues i këtij shkrimtari në disa nga veprat e përzgjedhura narrative (“Kufoma”, “Dragoi i fildishtë”, “Lëkura e qenit”, “Ëndrra e Damokleut”, “Te porta e Shën Pjetrit”, “Jetë në një kuti shkrepësesh”, “Bolero në vilën e pleqve” dhe “Gënjeshtarë të vegjël”), atëherë, është e rëndësishme që të thuhet se, pasqyrimin e këtillë e jep dhe e ndihmon edhe vetë personazhi i tij. Gjithë kjo, do të bëhet me qëllim që të tregohet edhe ajo se, ndonëse mendohet se brenda kësaj periudhe me një frymë të re, që, për dallim nga periudhat e mëparshme e ka shumë më të lehtë futjen e një identiteti të caktuar brenda suazave të një letërsie përfaqësuese për një kohë të veçantë, ka personazhe që krijohen dhe paraqiten të veçantë nga shkrimtarët. Këta të fundit me punën e tyre arrijnë të lënë gjurmë të thella jo vetëm te bota e lexuesit, por, edhe në raport me çdo krijues bashkëkohës.

I. Veprimet e personazheve

Letërsia e periudhës bashkëkohore shqipe na njeh me lloje të ndryshme shkrimesh, natyrat e të cilave, si për nga tematika, motivet a linjat dytësore, ashtu edhe për nga karakterizimet e brendshme të personazheve, bëhen nxitje për studime të shumta letrare, qoftë për të thënë diçka të re, ose, për të kritikuar për pikat e tyre të veçanta. Po të ndalohej në atë se si shkrimtarët i krijojnë veprat e tyre dhe në ç’gjëra mbështeten për to, mësohet se, jo të gjithë kanë një rrjedhë të zakonshme shkrimi, duke pasur parasysh edhe vetë natyrat e tyre të ndryshme nga njëri-tjetri. Në këtë mes hyjnë ata shkrimtarë, të cilët, ngjarjen që e përshkruajnë në vepër e kanë përjetuar vetë fund e krye, qoftë ajo ngjarje burgu, maltretime psikik, dhunimi fizik, deklasimi shoqëror, pjesëmarrje në krime e vrasje të ndryshme.

Gjithë kjo thuhet duke e pasur të njohur se: “Njeriu shqiptar, gjatë gjithë kohës së diktaturës, për shkak të bindjeve të tij politike dhe për shkak të veprimeve kundërshtuese ndaj atij sistemi politik, kishte përjetuar internimin, burgosjen e vrasjen, ishte dhunuar fizikisht e mendërisht”.²⁴ Herë të tjera atë ngjarje e rrëfejnë si ndodhi të dikujt tjetër, por që në to, ka shfaqur interes të madh.

Një frymë të tillë narracioni, e cila karakterizohet me një gjuhë të pasur e koncize, me shprehje mjaft figurative, me temë e stil bashkëkohor, qoftë edhe për nga përmbysja e rendit kohor, me personazhe që dalin nga rendi shoqëror sa herë që kanë ide të kundërta me sistemin që i detyron ta pranojnë të keqen, ose i dënon kur nuk pajtohen me të njëjtën, ose sa herë që luftojnë edhe për dashuritë e shumta e të pafundme patologjike, kanë edhe romanet e Fatos Kongolit, përfaqësuesit më në zë të periudhës së letërsisë bashkëkohore shqipe.

²⁴Adil Olluri, (2017), “Fytyra e tiranisë - Rrëfimi për diktaturën në romanin bashkëkohor shqiptar”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, fq. 50.

Duke pasur parasysh atë që ka thënë autori, se: *“Tema është porta nëpërmjet së cilës ne hyjmë në një vepër letrare, në këtë rast në një roman”*²⁵, qoftë ai edhe me temën e diktaturës mbi qenien njerëzore, e cila, më vonë del në faqe të caktuara me një narracion të për zgjedhur, atëherë brenda saj është e rëndësishme të shihen edhe veprimet e personazheve, të cilët njëkohësisht janë bartësit kryesorë të atyre ngjarjeve brenda sistemit diktatorial.

Duke e pasur të njohur faktin se: *“Personazhet e romaneve shqiptare me rrëfim për diktaturën janë ndër personazhet më të realizuara në mbarë letërsinë shqipe gjatë gjithë historikut të zhvillimit letrar shqiptar”*²⁶, atëherë për to është mjaft i rëndësishëm të dihet edhe veprimi në hapësira të caktuara demokratike (brenda e jashtë kornizave të shtetit shqiptar), përveç pikave/elementeve tjera ndërtuese për të, të cilat, njëkohësisht e ndërlidhin veprën, autorin dhe lexuesin e mëvonshëm. Këto gjëra, nuk shihen vetëm kur është në pyetje bota e pafundme dhe ndjenja (dashuria) e brendshme e personazhit, i çfarëdo kategorie e me çfarëdo tipizimi qoftë ai, por edhe kur vjen në pyetje bota e jashtme (rrethanat hapësinore, ndikimi i rrethit që mëton të humb e të krijojë identitet të gabuar për tjetrin, ndikimi i familjes a shoqërisë së një kategorie të caktuar), e cila me fuqinë e saj shpeshherë është nxitëse për shumë veprime të tij.

I. 1. Veprimet e jashtme të heronjve

Ajo që tashmë dihet për veprimin e jashtëm dhe që është e njohur edhe nga çdo studiues i mirëfilltë i artit të letërsisë, është se: *“Mënyra e thurjes së subjektit mbi bazën e veprimeve të jashtme mbetet forma më tradicionale dhe e përhershme në gjininë e romanit”*.²⁷ Kjo gjë nuk shihet vetëm në romanet të cilat i përkasin periudhës së letërsisë bashkëkohore shqipe, me theks të veçantë në ato të shkrimtarit Fatos Kongoli, të cilat, njëherë, janë edhe objekti studimor në këtë punim, por, edhe në shumë romane tjera, qofshin ato të kësaj periudhe letrare, ose, ato të periudhave të mëparshme, në të cilat dallohet edhe kultivimi i romanit.

Është e rëndësishme të thuhet se ngjarja brenda romaneve të Kongolit e përfaqësuar nga personazhe të caktuar, qofshin ato meshkuj, ose femra, është parësore/thelbësore për atë kohë sa shkon nga një episod te tjetri, nga një shkallë te tjetra, për t’u krijuar kështu edhe një botëkuptim i veçantë për kohën kur edhe ndodh ngjarja (koha e ndodhisë së ngjarjes), ose, për kohën kur e njëjta ngjarje shkruhet/(ri)tregohet nga autori (koha e shkrimit të ngjarjes).

Meqë në këtë pjesë flitet për ndikimin e jashtëm të heronjve të romaneve të Kongolit, është në interes edhe të vetë punimit të thuhet se, këta personazhe të ndikuar nga e jashtëmja, dalin në më shumë ngjarje, që të njëjtat janë të afta të përbëjnë, të ndërtojnë e të thurin një unitet, me ç’rast më vonë bëhen shkak që të lidhin shkak-pasojën nga një kapitull te kapitulli tjetër. Kjo lidhje nuk paraqitet vetëm në rastet kur personazhi pranon të veprojë ashtu siç edhe i kërkohet nga njerëzit në funksion, ose nga udhëheqësit e sistemit komunist, dhe kështu e fiton pasojën në gjëra të ndryshme të jetës, qoftë për veten, ose për tërë familjen e tij (ndër të cilat numëroheshin pasojat, si: deklasimi, ndalimi i shkollimit, burgimi etj), por edhe atëherë kur del kundër saj, e sërish takohet me një përfundim të tillë.

Të ndikuar nga kjo gjë, personazhet edhe pse me profesione të ndryshme e me shenja intelektualizmi në hapësira shqiptare me frymë komuniste, i lidhin shumë gjëra të përbashkëta, ndonëse të errëta e të padëshiruara, siç janë: pasojat e diktaturës, e shkuara e hidhur për popullin, varfëria e theksuar mendore e udhëheqësve ose eprorëve të padenjë komunistë, frika e humbjes së

²⁵Po aty, fq. 7.

²⁶Po aty, fq. 79.

²⁷ Floresha Dado, (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë, fq. 104.

dashurisë dhe jetës në suaza të urdhrave të domosdoshëm, dashuria e porealizuar për shkak të deklasimeve të ndryshme, tradhtia bashkëshortore dhe mosrealizimi i ëndrrave për të ardhmen.

I. 2. Veprimet e brendshme të heronjve

Për dallim nga ajo që u tha deri më tani, duhet të dihet se: *“Ekziston edhe romani, subjekti i të cilit mbështetet kryesisht tek veprimet e brendshme dhe, në rastet jo pak të dendura, subjekti është më kompleks, episodet e tij ndërthurin në vetvete veprimin e jashtëm me veprimin e brendshëm.”*²⁸ [sic!] Në të gjitha këto episode a kapituj të veçantë të romanit, dallohen edhe veprimet e brendshme të personazheve, të cilat, dallojnë mjaft nga të parat, jo vetëm për faktin se në to përqendrohet edhe vëmendja e lexuesit, por se të njëjtat japin njohuri edhe për atë se, çfarë ndien personazhi, për ç’gjëra lufton, ç’ka arritur dhe ç’dëshiron të arrijë në jetë, si ndikon te i njëjti marrëdhënia dashurore me një femër shqiptare kundrejt një të huaje, cilët faktorë ndikojnë në shembjen e kalasë së dashurisë ose sa luftojnë për realizimin e saj, e për shumë pika të tjera.

Në qoftë se veprimet e jashtme shprehnin nxitjen që personazhi të lëvizte dhe të realizonte kërkesat që ia thoshte vetes, ose i urdhëroheshin nga të tjerët, në këtë rast, pra, në veprimet e brendshme të heronjve njihen rastet në të cilat del në pah, dhe theksohet në veçanti vetëm bota shpirtërore e një personazhi, me ç’rast veprimet e jashtme vetvetiu dalin në plan të dytë e si të tilla merren edhe nga lexuesi. Me këtë rast, *“ngjarjet themelore lëvizin në botën e brendshme të personazhit dhe ndikojnë për të zbuluar dinamikën e saj.”*²⁹

Ky veprim që njëherë na njeh me një sistem diktatorial që e shkatërronte botën e brendshme të personazhit, duke e çuar kështu deri në shkatërrim a degradim të plotë, njëkohësisht na njeh edhe me psikologjinë e tij. Kjo si zakonisht, dallohet, kur personazhi merr rolin e rrëfyesit dhe për lexuesin duke rrëfyer në vetën e parë shpalos shumë gjëra për jetën, me ç’rast dendur dallohet mbresa, vuajtja për të djeshmen, dhembja për lirinë e plotë e të bollshme, humbja a pamundësia për të realizuar dashurinë e dëshiruar etj. Por, duke parë se shpalosja e këtyre ndjenjave të brendshme bëhet në vetën e parë edhe atë mjaft natyrshëm, duhet thënë se jo gjithmonë ato kanë rend kronologjik a rrjedhë të natyrshme, ngase, çdo roman bashkëkohor i Kongolit, njëjtë si për kohën, jep edhe përmbysje të veprimeve të sapopërmendura.

II. Subjektet vargore të romaneve

Tashmë është e njohur se letërsia e periudhës bashkëkohore shqipe, jo vetëm që njeh me shkrimtarë që në krijimtarinë e tyre letrare fusin personazhe bartës të veprimeve, herë kur vepra e tyre është me vëllime të shumta, ose, kur krijojnë një vepër tjetër, por, që personazhet i bartin edhe nga e mëparshmja, kjo periudhë letrare, njëkohësisht jep një varg ngjarjesh edhe brenda një romani të njëjtë, të cilat, i ndërlidhin me njëra-tjetrën.

Klasifikimi i romanit, ashtu siç ka pohuar edhe autorja, mund të ndiqet edhe sipas mënyrës së renditjes së episodeve që përbëjnë subjektin. Episodet mund të vendosen njëra pas tjetrës, në mënyrë vargore e secila nga to të plotësojë tablonë e përgjithshme të subjektit e të bëjë që ky subjekt të quhet vargor. Ky padyshim është tipi më tradicional për romanin.³⁰

²⁸Floresha Dado, (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë, fq. 104.

²⁹Po aty, fq. 105.

³⁰Floresha Dado, (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë, fq. 109.

Ky subjekt, që për periudhën bashkëkohore shqipe nuk është aspak i panjohur, shfaqet me një denduri mjaft të madhe në romanet e Kongolit, jo vetëm kur pasoja e diktaturës te personazhi paraqitet për një kohë të gjatë dhe bartet nga pjesa në pjesë, por, edhe atëherë kur personazhi vetë mëton për një lidhje të tillë. Ky mëtim i tij, ndihmon edhe vetë ndërtimin e romanit.

Subjektet e tilla, në pjesën më të madhe janë të mbushura me vuajtjet, mlllefet, dhunimet, dështimet, shfrenimet e gjithë personazheve (pavarësisht gjinisë dhe shtresës shoqërore), gjë që dëshmon se janë të pakta ngjarjet e romaneve të këtij shkrimtari që, brenda vetes ngërthejnë anën pozitive, ose rastet kur personazhet dalin triumfues edhe kundrejt të keqes së përgjithshme. Të njëjtën gjë, kur ajo bie mbi personazhin, e pohon edhe studiuesja, e cila ndër të tjera thekson se: Episodet që formojnë subjektin e tipit vargor mund të lidhen drejtpërdrejt ose me një personazh qëndror, ose me tërë ngjarjet, që përfshijnë vorbullën e tyre një grup personash.³¹ [sic!]

Meqë pena e Kongolit, përqendrohet në paraqitjen e një personazhi nën frymë diktature, që në pamundësi shpëtimi hynë në rrugë të gabuar, nëpërmjet të cilave paraqet edhe shfrenimet e veta erotike, atëherë është shumë normale që në to, të shihen fate e drama tronditëse, dështime të njëpasnjëshme, errësirë mbi fytyra të njoma etj.

III. Linjat/konceptimet paralele të ngjarjeve

Meqë nga njohuritë paraprake të letërsisë tashmë dihet se është pikërisht lidhja horizontale në roman ajo që njeh me fatin dhe me çdo hollësi të personazhit, qoftë ai kryesor ose dytësor, nga ajo, edhe për lexuesin është më e qartë rrjedha e veprimeve të tij të mëvonshme, nga të cilat, ai përfundon në një fund të drejtë ose bëhet pjesë e një fatkeqësie ardhur si pasojë e kohës në të cilën edhe vepron ai, qoftë ajo edhe koha komuniste. Lidhja në fjalë, përpos tjerash ndihmon që, gjatë leximit të romaneve të periudhës bashkëkohore, të mbahet vëmendja vetëm te protagonistin dhe te çdo lëvizje ose ndryshim i tij, për aq kohë sa frymon në roman, me ç'rast, jeta, fati, veprimet dhe çdo gjë tjetër që e/i karakterizon personazhin/et dytësor/ë të dalë në rend të dytë.

Ajo që e veçon prozën narrative të Kongolit, përveç “personazheve ndryshe” në periudhën e letërsisë shqipe bashkëkohore është edhe ndërprerja e papritur e rrjedhës së ngjarjes paraprake, për të vazhduar kështu menjëherë me një ngjarje të re, në të cilën, personazhi kryesor gjendet në vitet e së kaluarës (me ç'rast del në pah elementi letrar i quajtur retrospektivë), ose atë e shohim në një moshë më të madhe nga ajo që ishte para se të ndërpritej rrjedha në fjalë.

Kjo ndërprerje, përpos asaj që lejon të njihet një anë ndryshe e personazhit, të cilin autori e vë në rolin e protagonistit (herë pas here prapa të cilit, fshihet edhe vetë përjetimi i tij), njëkohësisht vërteton se në veprat e periudhës bashkëkohore jo çdo gjë rrjedh natyrshëm. Kjo gjë vërteton se aftësia e shkrimtarit bashkëkohor, i ndikuar e i nxitur edhe nga jashtë, mund të sjellë para lexuesit edhe shumë ngjarje në të njëjtën kohë, pra, të kemi rrëfime/linja paralele.

Kjo gjë nuk mund të merret e gabuara, për aq kohë sa shihet e drejtë dhe pranohet edhe nga studiuesit/kritikët e artit letrar. Për raste të tilla pohon edhe studiuesja se: “*Në momente të veçanta të rrjedhës së subjektit ndjehet nevoja e episodeve, konceptuar në drejtim vertikal. E kaluara i vjen në ndihmë të tanishmes në disa pika të ndërtimit të subjektit.*”³² Linja/konceptimi paralel në prozën narrative të Kongolit ndiqet kur linja e përgjithshme e zhvillimit të tij ndërtohet mbi disa nivele të fabulave që ecin paralelisht.³³

³¹ Po aty, fq. 111.

³² Floresha Dado, (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë, fq. 112.

³³ Po aty, fq. 113.

Kjo mjaft hapur dhe dendur shihet kur lexohet për fatin e personazheve të ndryshëm, jo vetëm për nga mënyra se si i përballojnë ngjarjet që ua sjell jeta, por të ndryshëm edhe për nga profesionet me të cilat mëtojnë ta kalojnë jetën, siç janë: Festim Gurabardhi, Krist Tarapi, Blendi Terziu, Dr. Edisoni, z.Irfani, Platon Guri, Sergei, Parashqevia, Isabela, Klodi, Lori, Adriana, Viola, Irma e shumë e shumë personazhe të tjerë, fatet e të cilëve, në kohën e tanishme, pra, në kohën e shkrimit të romanit, na njohin edhe me të kaluarën e tyre (qoftë ajo edhe më e errëta).

Kjo e kaluar jo gjithmonë shfaqë atë që lexuesit duan për këta heronj letrarë, meqë brenda të njëjtës gjen edhe jetën e tyre të shturur e të degraduar, pasojat e së cilës, i ndjekin edhe në vazhdimësi të kohës, pra, edhe atëherë kur guxojnë të ndërrojnë hapësirat e banimit e mundohen të ikin nga çdo gjë që i vret ose edhe i tjetëron. Na njeh me dëshirat e marra, të papranueshme e të shumta erotike të personazheve burra/meshkuj që me kohë ia kanë dhënë lamtumirën çdo gjëje të jetës gri, me çaste pendimi për tradhtitë e shumta e të vazhdueshme ndaj bashkëshortëve të padenjë për to, ose, me përdhunime e keqpërdorime të shumta të figurave femra. Këta personazhe që në të njëjtën kohë janë vetja e lexuesit rrëfohen vetë (pra, kur rrëfejnë në vetën e parë ngjarjet subjektive) ose rrëfejnë për të tjerët (rrëfime në vetën e tretë, njëjës/shumës për ngjarjet objektive) jo vetëm për të kaluarën në ndërlidhje me të tashmen, por edhe për dy e më tepër ngjarje paralele, të cilat, i përkasin ose të kaluarës, ose të tashmes si kohë.

Brenda këtyre prozave të gjata narrative, ajo që bie menjëherë në sy, e që në raste të caktuara shfaq një interes edhe për studiuesit, është edhe rrëfimi paralel, me ç'rast lexuesit e Kongolit njihen me një botë të veçantë moderne, personazhet e së cilës, janë produkt i vetë rrethanave, kërkesave dhe nevojave shoqërore të kohës së veprimit të tyre. Ky rrëfim, nuk ka shumë rëndësi në do të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, në të tashmen ose në të kaluarën, ngase mjafton që jep një ngjarje a episod të rëndësishëm edhe për vetë veprën.

Rrëfimet e ashtuquajtura paralele, nga vetë termi, lënë të kuptohet se, bëhet fjalë për më shumë të tilla brenda një episodi, një kapitulli apo brenda gjithë veprës letrare. Të njëjtat, nuk do të thotë se rrëfejnë për një personazh të vetëm në dy kohë të ndryshme, por, mund të ndodhë që të rrëfejnë për dy e më shumë personazhe edhe kur ata nuk kanë lidhje me protagonistin, por, shpesh, vetë paraqitja e tyre ndihmon ecurinë dhe karakterizimin e tij. Me rrëfime të tilla e të përfaqësuar nga personazhe të shumtë, jeta, fati dhe fryma e të cilëve do të shihet në kapitujt e mëvonshëm, kjo prozë e Kongolit është mjaft e pasur.

III. Rastësia në suaza ngjarjesh

Të gjitha ngjarjet të cilat autori vendos t'i fusë brenda një vepre të caktuar, përfshijnë brenda vetes edhe çaste të rastësishme, në të cilat shihet reagimi ose pranimi i personazheve ndaj diçkaje të panjohur a të pamenduar më parë. Në të gjitha romanet e Kongolit dalin situata a episode të ndryshme, rrjedha e të cilave, jo gjithmonë shkon drejt gjërave që edhe priten, sepse ndodh që për një çast të vetëm e të caktuar, personazhi të hyjë brenda një bote a situatë të rastësishme e pikërisht ajo rastësi të jetë vendimtarja për fatin e tij të mëvonshëm.

Se si shihet rastësia brenda një vepre letrare kur ajo i përket letërsisë së periudhës bashkëkohore shqipe është e nevojshme të theksohet pjesa e mëposhtme: *“Rastësia shfaqet në të si një domosdoshmëri, për të krijuar rrugë e fate të reja, konflikte e zgjidhje sa të logjikshme aq edhe të papritura. Prandaj edhe në ndërtimin e subjektit artistik, i cili në themel i nënshtrohet një logjike artistike, rastësia shpesh fiton vendin dhe rolin që i takon në rrjedhën e ngjarjeve. Duke qenë, në vështrim të jashtëm, në një kuptim “e papritur”, ajo së brendshmi është tepër logjike, është pjesë e të menduarit artistik të romancierit. Në këtë mënyrë, ndonëse në rrjedhën e natyrshme të subjektit një episod, një ngjarje mund të vijë si e papritur, si e rastësishme dhe*

skema e subjektit të shfaqet si më e "paorganizuar", në të vërtetë pikërisht ky episod mund të bëhet shkak për thellimin e konfliktit ose për hapjen e një konflikti të ti."³⁴

Tashmë duke qenë i njohur fakti se çështja e rastësisë brenda romaneve nuk është studiuar dhe nuk i është vënë theksi aq sa duhet, atëherë është e nevojshme të dihet se në një studim tjetër letrar pohohet se: *"Futja e rastit në rrjedhën e subjektit është forcë e brendshme, që sjell fatalitet ose shanse fatlume në jetën e personazhit. Ai i jep jo thjesht ngjarjes, por vetë karakterit, një dinamizëm të veçantë. Atëherë kur në vështrim të jashtëm struktura e subjektit duket e përsosur në harmoninë e saj, shfaqja e të rastësishmes nxjerr në pah domosdoshmërinë e zbulimit të një konflikti ose thellimin e tij.*"³⁵ Rastësi të tilla ndërthuren brenda vetes edhe proza narrative e Kongolit, edhe atëherë kur brenda saj përfshihet një ngjarje mjaft interesante, për të cilën në shikim të parë mendohet se nuk ka nevojë për diçka dytësore, meqë shihet si e plotë edhe për nga vetë natyra me të cilën shfaqet.

Ashtu siç mund të krijohet një ngjarje aty për aty, qoftë ajo në të mirë a në dëm të vetë personazhit, ashtu edhe në të gjitha këto romane, autori fut një element të rastësishëm, jo vetëm për të përmbushur pjesët që nga ai ose nga lexuesi shihen si të paplota, por për të ndryshuar tërësisht rrjedhat e tyre, e njëkohësisht për të mëtuar në ndryshimin e identitetit, karakterit të personazhit ose të tërë mentalitetit të masës në përgjithësi.

Kjo rastësi mund të jetë e çfarëdo lloji, por mbështetur në atë se ç'solli Kongoli për letërsinë dhe lexuesit bashkëkohorë, mjafton të përmenden rastet e mëposhtme, siç janë: medaljoni i njëjtë i varur në qafë, i bartur në tri breza femrash të bukura; të vështruarit e vetes në pasqyrë; trokitja e papritur në derë; shkrimi në murin e garazhit të një vrasjeje të papritur; udhëtimi drejt portës së të pamundurave e të paarrtshmeve; takimi me një femër që del nga faqet e një romani e jeton në hapësirë konkrete; kafeja nën rritëm muzike për fillimin e një bisede; ngjashmëria me një personazh tjetër; dhuratat që personazhi i fsheh edhe nga vetja; këmbimi i letrave; meloditë e simfonive botërore; variantet e shumta të femrave që dikur ishin të dashura e të dashuruara etj.

Të gjitha këto raste, të cilat me vetë natyrën e tyre përveç se dëshmojnë për një aftësi dhe imagjinatë të pazëvendësueshme të shkrimtarit bashkëkohor, njëkohësisht bëjnë që secila prej tyre të pranohet si e tillë edhe nga ana e lexuesit dhe të pranohen si të drejta për aq kohë sa çojnë në fundin e lumtur të një personazhi. Por, ato shihen njëkohësisht edhe aq të largëta për vetë faktin që, ndonëse përfaqësojnë pjesën e gjithsecilit prej nesh, edhe në çastet kur personazhi vuan nga paraqitja e tyre, ose humb brenda një bote të panjohur, sepse e ngatërrojnë edhe më tepër situatën. Por duke pasur parasysh se të gjitha rastet e tilla me jetë brenda letërsisë, vijnë nga pena të veçanta dhe përfaqësojnë një letërsi që personazhin e saj, veçanërisht atë të Kongolit e paraqesin mes modernes dhe eksperimentales, është pikërisht ky element që u jep natyrë të tillë.

IV. Kompozicionet si shfaqje romanesh

Meqë objekt studimi në këtë punim është romani dhe personazhi i Kongolit, atëherë është e nevojshme që të theksohet me pak fjalë se çfarë përfaqëson romani dhe nga çfarë e ka të domosdoshme të përbëhet, gjithnjë duke u ndalur në natyrën e romanit të periudhës bashkëkohore. Pra, romani si lloji më i ndërlikuar i gjinisë epike, përfaqëson në vetvete një

³⁴ Floresha Dado, (2003), "Teoria e veprës letrare - Poetika", TOENA, Tiranë, fq. 131.

³⁵ Po aty, fq. 132.

mikrobotë, të ndërtuar sipas parimesh të veçanta, që përcaktohen jo vetëm nga specifika e gjinisë letrare, por edhe nga bota ideoemocionale e autorit.³⁶ [sic!]

Të flasësh sot për romanin si krijim letrar pavarësisht llojit të tij, nuk do të thotë të ndalesh vetëm te çështja e tematikës ose te të gjitha motivet letrare që përfshihen brenda tij, për aq kohë sa nevojiten si elemente përbërëse; nuk do të thotë të ndalesh as te koha, as te hapësira, e as vetëm te personazhi, i cili, paraqitet kategori më vete pavarësisht se çfarë karakteri, niveli shoqëror, profesioni a identiteti ka (përfshirë në këtë rast identitetin gjuhësor, kombëtar, fetar), por duhet të shihet edhe pika tjetër ndërtimore mjaft e rëndësishme e quajtur kompozicion. Andaj duhet të theksohet se: *“Kompozicioni luan një rol thelbësor në procesin e përjetimit artistik, duke organizuar në një unitet emocional të gjithë elementet e strukturës së veprës.”*³⁷

Duke pasur parasysh çdo pikë të përmendur më lart, si dhe për ta vërtetuar se përse në atë botë të veçantë të shkrimtarit, të ndërtuar ndryshe nga e zakonshmja dhe ndryshe nga e imagjinuara, ka rëndësi edhe kompozicioni, do të ndalohet fillimisht në një mendim të studiueses, e cila ndër tjerash në librin e saj studimor thekson se: *“Romani e tërheq lexuesin në një botë pothuajse të paprekshme, që shihet dhe përjetohet emocionalisht; në të shfaqen karaktere të veçanta, marrëdhënie të ndryshme në hapësirë dhe në kohë, rrjedhje ngjarjesh në përmasa dhe mjedise të caktuara. Ka edhe një proces specifik kalimi nga përjetimi i autorit në botën e veprës letrare, gjë që nxjerr nevojën e një organizimi të veçantë të “kornizës” së krijimit artistik. Në këtë proces rol themelor luan kompozicioni i veprës.”*³⁸

Të gjitha këto nuk mund të jenë të plota e të mjaftueshme për veten e tyre nëse brenda romanit si unitet i arrirë, nuk ka ndërlidhje/reciprocitet. Sepse siç ka theksuar edhe autorja, romani njih disa ligje të përgjithshme kompozicionale, të cilat burojnë nga mënyra e vështrimit të botës, nga kuptimi i marrëdhënieve dhe i lidhjeve të dukurive të ndryshme të saj, si dhe nga intuita artistike e romancierit.³⁹ Vetë paraqitja e tij përkon edhe me natyrën e romanit, duke u ndërlidhur kështu njëkohësisht me temën e me çdo gjë tjetër që përbën strukturën e një vepre.

Kjo, shumë lehtë dallohet po të ndalohet të shihet se si ndërlidhet tema e diktaturës me vetë personazhin (qoftë ai mashkull apo femër), i cili njëkohësisht përfaqëson edhe motivin e imët tematik brenda së njëjtës (burgimin, përdhunimin, vrasjen, vetëvrasjen, diferencimin klasor, internimin, deklasimin, përndjekjen etj). Është pikërisht ky personazh ai që bart në vete pasojat e një diktature të tillë, që dallon nga të tjerët ose shkrihet brenda tyre, e më vonë del pikërisht në rolin e dikujt që i ikë jetës, për aq kohë sa është si gjithkush, por, nuk pranohet nga askush.

Për atë se si del ky kompozicion në romanet e Kongolit e ç’natyrë ka ai kur përfshihet brenda tyre, do të jepen në veçanti disa nënndarje të mëposhtme. Por, paraprakisht është e rëndësishme të dihet se, kur flitet për kompozicionin si akt i brendshëm, që përpunohet gjatë procesit të frymëzimit dhe intuitës së shkrimtarit, nuk mund të mos pranohet edhe mekanizmi i përpunimit të ndërgjegjshëm të ndërtimit të romanit.⁴⁰

³⁶Floresha Dado, (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë, fq. 150.

³⁷Po aty, fq. 150.

³⁸Po aty.

³⁹Po aty, fq. 152.

⁴⁰Floresha Dado, (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë, fq. 153.

IV. 1. Karakteri monolit

Po të ndalohet në nëndarjen e parë të kësaj pjese, shihet se është pikërisht ky karakter ai që i jep veprës letrare unitetin e organizimit artistik e që ia nënshton të gjithë elementet strukturore logjikës së realizimit të mendimit artistik. Ky, meqë llogaritet si parim themelor në kompozicionin e romanit, shihet se siguron harmoninë kuptimore dhe estetike të romanit si dhe një fizionomi origjinale.⁴¹ Uniteti në fjalë, në cilindo roman, arrihet sidomos kur në të shfrytëzohet retrospektiva, njëra ndër elementet letrare më të shfaqura në prozën narrative të Kongolit, me anë të së cilës njihet e kaluara e personazheve dhe çdo pikë përbërëse e saj. Kjo nuk bëhet vetëm kur në të ata fshehin çaste të bukura dashurie edhe nëpër kryeqytete të ndryshme të botës, por edhe kur nëpërmjet saj, rrëfëhet jeta nën diktaturë dhe çdo lloj tjetër dëshpërimi a shkatërrimi, qoftë edhe ai psikik.

Çështja e retrospektivës në këto proza narrative nuk del si e veçantë, në mënyrë që të dallohet një episod i të kaluarës, por ndërthuret me rrëfimin e ngjarjes në të tashmen, e në mënyrë të tillë dalin në pah elemente që ndihmojnë rrjedhën e romanit edhe kur ai ka dinamikë veprimi e mendimi, ritëm lëvizës, lëvizje të brendshme vepre, tablo statike të linjave të rrëfimit, qofshin ato edhe rikrijime, emocione autori ose interes lexuesi. Vlen të përmendet edhe ajo se, kjo retrospektivë shpeshherë del edhe në anë të kundër të së tashmes, jo vetëm pse ka dallim të madh në kohë, por edhe për vetë faktin që ajo mund ta kundërshtojë të tashmen e të tregojë një fytyrë/natyre krejtësisht tjetër të asaj që rrëfen autori, ose kur këtë rol e merr vetë personazhi. Por, në raste të caktuara, kjo shihet si e drejtë dhe pranohet si e tillë duke u mbështetur në atë, se: *“Kontrasti, duke qenë kundërvënie, përmban në vetvete mundësira të pafund të krijimit të situatave emocionale, të shprehjeve të figurshme.”*⁴² [sic!]

Ndonëse, tashmë është thënë se: *“Romani shfaqet si një kompozim unik, me lidhje të brendshme kuptimore midis episodeve, skenave, kapitujve, të cilat konceptohen, ndërtohen sipas parimeve të ndryshme, në përputhje me mundësitë shprehëse emocionale që ka secili parim”*,⁴³ duhet të dihet se ky kontrast, nuk paraqitet vetëm në raport me personazhin si karakter i veçantë brenda romanit, por shfaqet dendur kur autori mëton të vë në kontrast ndërmjet veti edhe dy kapituj.

IV. 2. Rrëfimet unazore

Duke pasur parasysh faktin se: *“Shumica e romaneve tona ndërtohen me kapituj, skena që, ose janë midis tyre shkak-pasojë, ose vijnë për të shtuar secila rrethin e ngjarjeve, personazheve, ose për të zgjeruar përfytyrimin rreth një ngjarjeje a personazhi të veçantë”*,⁴⁴ është e nevojshme të theksohet se jo gjithmonë ato kanë rrjedhë të zakonshme/të rëndomtë që të fillojnë diçka, e në përfundim të dalin në diçka krejtësisht të një natyre tjetër. Gjithë kjo thuhet duke u mbështetur në atë që tashmë edhe krijohet në letërsi, pra, në rrëfimet e ashtuquajtura unazore, ngase ndodh shpesh që gjatë shkrimeve të këtyre veprave letrare, autorët, pavarësisht se cilës periudhë i takojnë, ndalen në rrëfime që kthehen në atë që përbën qendrën. E njëjta gjë ndodh edhe me prozën e Kongolit, e cila përpos të veçantave dhe risive në letërsi, arrin të shfaqet edhe me kompozicion të tillë.

⁴¹ Po aty, fq. 154.

⁴² Floresha Dado, (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë, fq. 155.

⁴³ Po aty, fq. 160.

⁴⁴ Po aty, fq. 165.

Por, kjo nuk vjen vetëm si rezultat i tematikës dhe motivit letrar që trajtohet në të, por edhe nga vetë nevoja që, nëse personazhi vihet në qendër, lexuesi duhet të jetë ai që do të dijë gjithçka për të, si për të sotmen e ngërthyer nga kujtimet dhe degradimi, ashtu edhe për të kaluarën e tij. Andaj jo më kot personazhi i quajtur Krist, Parshaqevi, Blend, Klod ose Platon del me një natyrë të tillë, e përpos asaj që e tërheq lexuesin ta dëgjojë/lexojë deri në fund rrëfimit, ai edhe vetes ia kujton çdo të kaluar.

IV. 3. Përmbysja kompozicionale

Duke e pasur tashmë të njohur faktin se brenda një krijimi letrar, që parqet një rrëfim në mënyrë të zgjeruar dhe atë e realizon me mjete të ndryshme shprehëse, dihet se ka elemente që ndonëse nuk janë të patjetërsueshme, prania e tyre e shtynë edhe shkrimtarin e letërsisë së periudhës bashkëkohore ta shfrytëzojë një gjë të tillë. Që kjo gjë të dalë sa më interesante, shkrimtari, gjatë hartimit të veprës shfrytëzon lloje të ndryshme kompozicionesh. Një lloj i kompozicionit brenda romaneve të Kongolit, është përmbysja, e cila: *“Krijohet me prishjen e rrjedhës së rrëfimit ose rendit të ngjarjeve, episodeve.”*⁴⁵ Por, në suaza të kësaj pjese duhet të dihet edhe ajo se: *“Ky “çrregullim” pranohet në veprë atëherë kur në një çast të caktuar ndjehet e nevojshme që të silllet diçka nga e kaluara, të plotësohet e të thellohet më tej njohja mbi personazhin.”*⁴⁶

Në romanet e Kongolit, ky kompozicion ndihmon që veprimi të bëhet më tërheqës, ta rëmbejë lexuesin në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen e personazhit,⁴⁷ e të kuptojë gjithçka që ka të bëjë jo vetëm me këtë të fundit, si kategori e veçantë brenda ngjarjes, por edhe për çdo rrethanë a faktor që ka ndikuar dhe ka qenë nxitës në krijimin e tillë të këtij shkrimtari. Me këtë veçanti, studiuesi dhe lexuesi nuk e vlerëson vetëm njohjen e personazhit, por njëkohësisht vlerëson edhe njohjen e rrënjëve për të kaluarën, qoftë ajo edhe e më shumë personazheve (personaliteteve) brenda ngjarjeve të prozës narrative. Në këtë rast, nuk luan rol të rëndësishëm vetëm mënyra se si rrëfëhet ngjarja dhe ç’paraqet shkrimtari si të veçantë a të domosdoshme për personazhin e tij, por edhe ajo që për të, të silllet edhe një çast nga e kaluara.

Literatura e shfrytëzuar:

- [1]. Dado, F. (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë;
- [2]. Olluri, A., (2017), “Fytyra e tiranisë - Rrëfimi për diktaturën në romanin bashkëkohor shqiptar”, Instituti Albanologjik, Prishtinë.

⁴⁵ Floresha Dado, (2003), “Teoria e veprës letrare - Poetika”, TOENA, Tiranë, fq. 167.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Po aty.